



## E K S T R A K T

**i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, mbajtur më 02.03.2023, duke filluar në orën 13:30.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fatime Demolli-Mustafa, kryesuese, Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Armend Ademi, Gyltene Retkoceri dhe Jeton Canhasi.

**Mungoi:** Ermira Shabani.

**Në mbledhje ishin të pranishme edhe:** Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut, Roland Peraj, këshilltar i Kryetarit të Kryeqytetit, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë se Mirëqenies Sociale dhe Berat Cakaj – interpret.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fatime Demolli, kryesuese e komitetit me këtë

### REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit KPAK-ra;
2. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;
3. Monitorimi i Planit të Veprimit;
4. Të ndryshme.

**Fatime Demolli**, kryesuese e falënderoi për prezencën në takimin e sotëm këshilltarin e kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. Roland, ku është kënaqësi për Komitetin me pas këtu në mbledhje. Para se të kalojmë në diskutimin e pikave të rendit të ditës do të doja të prezantohemi para Rolandit secili prej nesh se kush jemi, prej kujt përbëhet komiteti dhe çfarë profesioni kemi. Roland Peraj, u prezantua se është këshilltar me titull këshilltarë politik i Kryetarit Përparim Rama, ku mbuloj më shumë fushën e sektorit të arsimit momentalisht dhe pak a shumë tash kam filluar t'i marr disa dimensione që ndërlidhen me fushën e arsimit.

Më herët kam qenë menaxher i programeve në "Down Sindrom Kosova", për disa vite kështu që fushën e AK-ra, e njoh mënyrë pak më profesionale për shkak të angazhimeve.

Kam punuar në USAID-in amerikan dhe GIZ-in gjerman dhe të gjitha përvojat janë lidhur me pjesën e arsimit dhe trajtimit të konceptit të gjithë përfshirjes.

Sa i përket PAK-ra, për mua është kënaqësi me u takuar dhe me u njoftuar dhe gjithmonë keni me e pas derën hapur, Komuna është e hapur të bashkëpunojë.

**Fatime Demolli**, kryesuese e falënderoi drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, për prezencën në mbledhjen e dytë të KPAK-ra, ku është kënaqësi për ne që të njëjtën kohë t'i ndajmë të mirat që i kemi në drejtorinë e juaj por edhe t'i shohim hapat tutje se si mundemi me ecë dhe me i rregulluar disa pika të cilat na kanë mbetur në Planin e veprimit.

**Adelina Sahiti**, drejtore tha se ju e dini Drejtoria e Mirëqenies Sociale e mbulon një gamë të gjërë të aktiviteteve dhe kategorive shoqërore, e normalisht që për ne ka rëndësi shumë të madhe edhe aktiviteti që zhvillon komiteti dhe gjithçka tjetër që ndërlidhet më fuqizimin e personave me AK - ra.

Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka bërë disa ndryshime të vogla pozitive e kam fjalën për qasjen fizike brenda dy godinave të Komunës së Prishtinës. Kemi bërë edhe shirita taktil, nivelimin e sporteve që përdoruesit e karrocave të e kenë më të lehtë qasjen kur i marrin dokumentet dhe normalisht më të lehtë bashkëbisedimin me zyrtarin e gjendjes civile i cili u jep edhe dokumentet që ata i kërkojnë.

Jemi duke punuar dhe përkohësisht me kérkesën e kryetarit e kemi larguar pjerrinë e cila ka qenë e vendosur jashtë e cila nuk ka përbushur standardet e kërkua e tjerë, po ashtu edhe për gjuhën e interpretit në takim me nënkyetarin Zogaj e kemi diskutuar që jemi të gatshëm për të vazhduar bashkëpunimin dhe gjuhën e interpretit të e kemi sërisht në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës. Shumë shpejtë do ta hapim thirrjen publike për mbështetje financiare të organizatave të shoqërisë civile të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategoritë e ndryshme sociale në Kryeqytet.

Kështu që unë i bëj thirrje Armendit dhe të gjithë juve të aplikoni sërisht dhe të jeni pjesë e kësaj thirrje dhe të jeni pjesë e kësaj mbështetjeje që Komuna e Prishtinës e bën në baza vjetore për ju dhe që aty t'i mbulojmë të gjitha nevojat dhe kérkesat e PAK, në Prishtinës.

Po ashtu informoi se në ditën ndërkombëtare të përdoruesve të karrocës, kanë pasur një takim me z. Maliqi nga "Hendikosi", ku e shprehëm mbështetjen tonë bashkë me drejtorin e shëndetësisë z. Izet Sadiku, sepse jemi dy lëmi të cilat gërshtetimi me njëra tjetrën, PAK sa kanë nevojë për shërbime sociale aq kanë nevojë dhe për shërbime mjekësore.

Po ashtu është e rëndësishme që edhe qasja në hapësirat publike të jetë e një niveli tjetër dhe normalisht edhe drejtoritë përkatëse janë të angazhuar dhe të përkushtuar që kjo të ndodhë në këtë mandat, kështu që ka shumë të dëgjojmë kérkesat e juaja, të shohim se ku kemi ngecur në planin dinamik, në planin e punës, janë bërë punë të mëdha, por e di që ka ende punë për të bërë dhe jam sot këtu për tu dëgjuar dhe për të parë se çka mund të bëjmë diçka edhe më mirë se kaq.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha e ceku drejtorja aplikimin që do të hapet thirrja së shpejti për subvencione, komiteti këtu e ka një mangësi sepse nuk mundet me aplikuar në këto thirrje për shkak të një kartele të vet të cilën e posidon. Ne kemi pasur aktivitete të ndryshme të cilat i kemi mbajtur, i kemi bërë në mënyrë vullnetare prej anëtarëve, ka qenë e vëtmja Drejtoria e Sportit që na ka ndihmuar në mënyrë që njëri prej anëtarëve tanë të aplikojë me kartelë të veten personale, ku kemi organizuar për 12 qershor një garë lidhur me shah.

Po ashtu parashtroi pyetjen se si mund të e ndihmoni komitetin këtë radhë kur të hapet kjo thirrja për subvencione, sepse komiteti ka shumë ide të mira dhe duke u bazuar në terren dhe si mundemi ne këtë pjesë me përfituar prej subvencioneve të drejtorisë së juaj.

**Adelina Sahiti**, drejtore dha sqarime.

**Mehreme Llumnica**, tha se ka qenë në komisione, ka përfaqësuar OJQ-të, këto grante dhe subvencione janë më shumë për shërbime sociale dhe direkt, kështu që tonat janë shumë atraktive janë më shumë evokim, lobim, ne jemi zëri i qytetarëve, por kemi pak problem mu fokusuar në aktivitete konkrete siç e cekët. Mirëpo disa drejtori me i shikuar që mundemi me korresponduar për shembull për arsim, në një aktivitet lidhur me arsimin, për kulturë dhe sport mundemi me korresponduar me projekte të dikastereve për shërbime sociale duhet përfituesit dhe shërbimet me qenë shumë konkrete.

**Adelina Sahiti**, drejtore tha se gjithsesi do të interesohem për këtë çështje.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se si komitetin dua të pyes dhe të jemi më shumë të informuar si qëndron puna në PAK-ra, të cilët nuk kanë mbështetje dhe kanë nevojë të vijnë në shtëpinë e të moshuarve.

**Adelina Sahiti**, drejtore dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga para folësja.

**Mehreme Llumnica**, tha se aplikimi i OJQ-vë, me qenë krejt të licencuar për shërbimet.

**Adelina Sahiti**, drejtore tha se besoj që edhe këtu kemi me dhënë një kontribut.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha në PV e kemi me i siguruar drejtoria juaj hapësirat për qëndrime ditore të PAK-ra dhe që stafi me qenë profesional në këtë drejtori që i trajton, andaj po iu pyes se kur do t'i hapni këto dhe kur do të punësoni staf.

**Adelina Sahiti**, drejtore dha sqarime për pyetjen e parashtruar.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se keni mungesë të stafit në Drejtorinë e Mirëqenies, stafin kur do ta punësoni.

**Adelina Sahiti**, drejtore tha se stafin në Drejtori të Mirëqenies mund të them që e kemi konsoliduar mjaftueshmë mirë, pa e përmendur QPS.

Në QPS, i kemi marrë 12 persona në staf të cilët janë rekrutuar përmes prokurimit me kontrata, dhe kemi mbushur një hapësirë të madhe në QPS.

**Ramadan Salihu**, sa i përket çështjes së shtëpisë së të moshuarve a është informatë e konfirmuar që shtëpia e të moshuarve në Prishtinë, nuk pranon nga PAK, e ka kriter.

**Adelina Sahiti**, drejtore jo shtëpia e të moshuarve pranon edhe nga PAK.

**Gyltene Retkoceri**, tha se ka bërë disa seanca me një përfituese në shtëpinë e të moshuarve në mënyrë vullnetare dhe aty më ka rastis me u informuar që kriteret janë personat që nuk kanë djem munden me u pranuar, dhe PAK -ra nuk munden me u pranuar, e kam parë që aty kishte mungesë të stafit, kur kam qenë unë para dy viteve kanë qenë mbi 70 persona, e është vetëm një psikologe.

**Adelina Sahiti**, drejtore po është vetëm një psikologe. Sot pata takim me tërë stafin, aktualisht janë të punësuar 53 persona ndërsa me organo gram janë 60, nuk po e di 70 a kanë qenë me kontrata mbi shërbime apo çfarë nuk e kam idenë kështu që ato hapësira do t'i mbulojmë, jemi shumë të interesuar sepse nuk ka gjellëbërës, nuk ka vozitës, nuk ka stomatolog e të tjera.

**Gyltene Retkoceri**, tha se vjen kohë pas kohe psikiatri, stomatologu, mjeku familjar etj.

**Mehreme Llumnica**, tha se ka qenë në disa projekte kohë pas kohe për PAK, të cilët kanë qenë në një gjendje shumë të rëndë të pa lëvizshëm, as nuk ka pas infermier afër, as kushtet higjienike, as përkujdesje edhe vetëm qëndrimi në ato si baraka.

#### Pika e parë

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit KPAK-ra.**

**Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.**

#### Pika e dytë dhe e tretë

**Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të kufizuara dhe Monitorimi i Planit të Veprimit**

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se e kemi të rëndësishëm PV-të, monitorimin e tij dhe raportimin e tij, plan i cili është që nga viti 2021 deri 2023 dhe ende nuk e dimë se çfarë po ndodh në drejtori, në teren dhe ato të tjera, e kemi pas të vështirë me gjetur donatorë që me pas mundësi me e përfunduar këtë procesin e zbatimit të tij, ne me Premtimen e kemi mbajtur një takim me Z. Roland, i cili na ka përkrahur jashtë mase sa i përket monitorimit të PV-të.

Përveç kësaj e kemi caktuar një takim me nënkyryetarin me z. Alban Zogaj, i cili na ka ftuar për të diskutuar për PV-të dhe për hapat të cilët do të ndërmerrin tutje, mirëpo nuk është ndierë mirë dhe është shtyrë për ditë të tjera.

Mendoj që për komitetin është me rëndësi me e pas një raport të këtij PV-të, plani të veprimit, një monitorim të planit të veprimit, meqenëse e kemi Rolandin këtu atëherë po pres me pa se si mundet ta përkrahë Komuna këtë monitorim.

**Mehreme Llumnica**, propozoi që me qenë sa më aktiv në monitorim do të ishte mirë që ne si anëtarë me e gjete një bashkëveprim me ndonjë organizatë shumë të madhe që ndoshta do të kishte mbledhur të dhëna më shumë, sepse ata janë ekspertë në fusha të ndryshme sepse neve do na ikin informacionet nëpër drejtori.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se ka pas një takim me Fatimen dhe Premtimen dhe kanë diskutuar për këtë PV-të, e kam trajtuar, e kam lexuar mendoj që keni qenë shumë modest në kërkimin e të drejtave, të gjitha këto që janë kërkuar në këtë PV, asnë nuk është luks, për mua është zhgënjiye nëse unë i takoj kabinetit që udhëhiqet nga një kryetar shumë modern dhe përqafon ide të reja dhe është shumë gjeneroz me të gjitha kategoritë shoqërore, duke përfshirë këtu edhe PAK-ra, mos me mbërri me përfshirë një pjesë të pikave, kur kam biseduar me kryetarin, ai nuk e kishte idenë për planin e veprimit.

Po ashtu ceku se kryetari kur fliste me IBRD, që është organizatë buxhetore që po na i sjell autobusët e rinj në Kryeqytet, njëra prej kritereve që ai pyet është se a do të jenë të përshtatshëm për PAK-ra, do me thënë është njëra nga kriteret që vetë e vendosë në tavolinë.

Po ashtu tha se ka qenë shtysë direkt i kryetarit punësimi i 25 psikologëve në shkolla, e pastaj edhe punësimit të 3 personave që është numër modest.

Unë me direktivë të kryetarit dhe pas takimit që e kam pas me dy koleget jam duke e hulumtuar numrin e të punësuarve komplet në të gjitha dikasteret. Në këtë rast ne i kemi diku rrëth 700 punëtorë në dy objektet e Komunës së Prishtinës, në disa njësi të vogla vartëse jashtë, duke përfshirë këtu edhe Qendrën për Punë Sociale, mirëpo ne kemi edhe disa ndërmarrje publike të cilat kanë numër shumë të madh të stafit dhe jemi duke shkuar në atë drejtim që me e pa se sa është numri i PAK-ra, që na obligon si ligj fillimi, e pastaj kur e mbulojmë pjesën ligjore atëherë me shkuar me idenë që me e përfaqësuar vullnetin tonë që i bie me rritë numrin.

Po ashtu ceku se tek PV-të, kam synuar meqë kam punuar shumë gjatë me sektorin ndërkombëtar dhe kam pas qasje me gjet financa tek "Save The Children", kam diskutuar me menaxherin ndërkombëtar që e kanë aty dhe ua kam dërguar PV-të dhe na kanë kthyer përgjigje që nuk mundën të bëjnë deri më 10 janar të vitit të ardhshëm. Për shkak që ligjërisht i bie që ky është funksional deri më 31 dhjetor 2023, që çfarë do lloj interpretimi mbi këtë plan është i pa mundur në aspektin ligjor të bëhet për shkak që nuk u kompensohet si punë, ata munden të na paguajnë një konsulent apo grup ekspertësh që ulen dhe e shohin planin dhe shkojnë i intervistojnë drejtoritë.

**Pretime Preniqi**, tha se ndoshta është Komuna që e bën një monitorim një vjeçar, se p.sh me pa që tash me monitoruar 2022 sa është kryer 2022 sepse aty është me vite, e pastaj përfundimin e të gjithë planit.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se tek pjesa e fragmentimit në vite unë po mendoj çfarë mundet të bëhet, unë do të kisha thënë që ekipi këtu duhet me filluar me u bërë bashkë, që në këtë rast unë do t'i kisha ndihmuar.

**Mehreme Llumnica**, tha se ideja edhe e Rolandit edhe e imja është fusha e ekspertizës, ne me bashkëpunuar me ekspert të specifikuar.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se absolutisht, ajo formë është më profesionale, sepse në fund të ditës një monitorim i plotë nuk mund të bëhet nga vetë pala e cila e bën një dokument në këtë rast. Unë kam kërkuar prej "Save The Children", jo vetëm PV-të, por strategji afatgjate së paku 5 vite me qenë që neve na e bën atë.

**Mehreme Llumnica**, tha se në disa komuna kanë bërë strategji, besoj pas 2023 që kanë me filluar edhe të ne me strategji, ashtu ka qenë ideja.

**Roland Peraj**, këshilltar propozoj meqë i kemi këto problematika që mos me i munduar anëtarët, unë do kisha menduar kështu, për të bërë një plan të analizës një vjeçare me e marr përsipër me e bërë vetë ne, mundemi me u nda unë, Fatimja, Premtimja dhe kushdo tjetër që dëshiron me qenë pjesë dhe me i fragmentuar detyrat dhe me e ndarë me një Google Drive, dhe secili me dhënë komente mbi bazën e shkrimit që bëhet, dikush që është më shpesh në Komunë që mundet me i realizuar intervistat apo takimet me drejtorët.

Po ashtu tha se i ka marrë informatat si për numër të PAK-ra dhe të gjitha kontaktet i kam bërë me e-mail dhe nuk kam pas nevojë fare me u takuar fizikisht dhe ndoshta kjo është një përparësi sepse unë kam një pozicion politik këtu dhe kur po iu shkon një e-mail nga kabineti po është më ndryshe, kështu që për çfarë do informate me bëni CC ose ma dërgoni mua direkt e pastaj unë e përcjelli, kështu që kjo është sa i përket PV-të.

**Mehreme Llumnica**, tha se kam një ide, në mesin tonë ka njoħes tē fushave tē ndryshme, Ramadani është njoħes i legjislacionit, ndoshta mundet me hyre nē grupin e ngushtë me ju, kemi edhe Gyltenen nē fushën e psikologjisë, atë dua me e kerkuar, unë kam përvojë nē fushën e mirëqenies dhe shëndetësisë, kështu që nëse ne nuk mundemi me qenë direkt aktiv nē monitorim a mundemi me shtuar ndonjë koment me e-mail, meqenëse nuk po mundem me dhënë një kontribut tē drejtpërdrejtë, jam e gatshme tē ndihmoj.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se patjetër pa diskutim.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se patjetër, ne gjithmonë kemi shkuar me sugjerime, komente, plotësimë.

**Premtime Preniqi**, tha se më mirë i dini ju problemet nē PAK, sidomos nē aspektin e mirëqenies dhe shëndetësisë.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se atëherë po mbetet që me monitoruar apo me raportuar për vitin 2021 dhe 2022, që po i bie për dy vite faktikisht, e për vitin 2023 raportimi me qenë nē fund tē vitit apo eventualisht nē janarin e vitit 2024.

Atëherë le të mbetet ashtu që një grup i personave më të ngushtë tē punojnë nē këtë pjesë por gjithsesi duke i përfshirë të gjithë anëtarët e komitetit sepse secili anëtarë jep kontribut tē veçantë nē këtë. Po ashtu e potencuat me një analizë që e keni bërë janë diku 700 punëtorë nē Komunë tē ndarë nē njësi e degë, sa janë me AK-ra tē punësuar është shumë me interes me i ditë.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se tani kjo është akoma nē fazë tē hulumtimit, mirëpo për fat tē keq janë diku 13 apo 14 persona.

**Premtime Preniqi**, pyeti se a është fjala edhe me ndërmarrje publike.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se jo pa ndërmarrje, vetëm Komuna, për fat tē keq ky objekt e ka vetëm një PAK -ra.

**Fatime Demolli**, kryesuese shprehu shqetësimin sepse një Kryeqytet, një Komunë siç jemi ne Prishtina, të kemi kaq pak nga PAK-ra, me të vërtetë është shqetësim.

Nuk e di kabinetin i kryetarit a e ka menduar ndonjëherë këtë pjesë, sepse e keni atë kompetencë me thënë po i marrim 5 nga PAK, e po i vendosim në secilën drejtori, e keni këtë mundësi ta bëni.

**Roland Peraj**, këshilltar dha sqarime, në këtë numrin 700 të punëtorëve i bie që duhen edhe 2 punëtorë dhe jemi në rregull me ligjin, sepse 700 pjesëtuar për 50 i bie 14 persona gjithsej të punësuar.

**Mehreme Llumnica**, tha se shumica e personave janë pranuar më herët jo si PAK-ra, ky lirimi i tatimit në pagë i ka stimuluar me e pranuar si person që është pranuar. Ne kemi qenë me Burimet Njerëzore dhe kemi bërë një formularë të aplikimit, që p.sh. inkurajohen PAK -ra, me kushte të barabarta, me kualifikime po flas, tanë e kanë larguar zyra e Burimeve Njerëzore.

**Roland Peraj**, këshilltar pyeti a është larguar tash apo më herët.

**Mehreme Llumnica**, u përgjigj qe një vit e gjysmë apo dy po ashtu tha se ka qenë edhe Ligji për shërbyesit civil e din Ramadani atë, por tash është një lehtësim sepse është ligji për mbrojtje nga diskriminimi, len masa affirmative.

**Ramadan Salihu**, tha se monitorimi nënkuption që me i thënë autoritetit që këtu ke ngecë, këtu je mirë, e këtu e ke përkrahjen tonë, si komitet ne e kemi marrë monitorimin vetëm fatkeqësisht, sepse nuk kemi kapacitete, monitorimi më i mirë i PV, ka ndodhur prej "Hendikosit", në bashkëpunim me komitetin i cili ka qenë për një vit dhe ka qenë i financuar nga KCSF-ja, i cili ka qenë mjaft i detajuar dhe të cilin ne e kemi filtruar dhe e kemi dërguar në asamblenë komunale të Prishtinës, me rekomandime, i cili është miratuar.

Monitorimi i ka së paku tri specifika: e ka metodologjinë se në çfarë po orientohemi me monitoruar, a punësimin, aspektin fizik, apo vullnetin. Metodologja e ka objektin se kë do ta monitorojmë dhe subjekti, d.m.th se kush e monitoron. Është shumë më respektabile ajo që thoni ju që monitorimin ta bëj një organizatë më autoritet më të madh se komiteti, me qenë me e monitoruar siç thatë ju "Save The Children", apo kushdo qoftë prej organizatave respektabile, ai monitorim ku të troket në derë gjen një përkrahje më të mirë.

Po ashtu tha komiteti do të ishte mirë me këto kapacitete që i ka një dokumenti monitorues me i dhënë vulën apo jo për të shkuar në asamble komunale, pra e bën dikush tjetër i specializuar, ne e shikojmë se a i plotëson kushtet, a kemi çfarë të plotësojmë dhe në fund ia japim të drejtën për të shkuar në asamble komunale.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se mendoj që ju keni kapacitet të mjaftueshëm për të na dhënë shkollë në fushën e aftësisë së kufizuar, mirëpo ideja është që një subjekt i jashtëm për një dokument që e ka bërë një grup është më valid sepse e bën më të pavarrur gjykimin, për çështje ligjore jam konsultuar edhe me Zyrën ligjore z. Kçira ka mbetur me na u përgjigj, sepse unë kam menduar këtë idenë që me e bërë vetë grupin ekipi monitorues, që ju me qenë të angazhuar, pse mos me e kryer ju vetë, por me e gjet një mundësi kompensimi dhe në aspektin ligjorë me e pa këtë mundësi se si bëhet.

## Pika e katërt Të ndryshme

**Gyltene Retkoceri**, tha se Drejtoria e Arsimit e ka bërë shumë mirë me punësimin e psikologëve, pasi që në QMF dhe QKMF nuk ka asnë psikologë, pra ka numër të madh të psikologëve klinik dhe ka nevojë shumë të madhe e nuk ka asnë të punësuar.

**Fatime Demolli**, kryesuese pyeti se a ka psikiatër në QMF-të.

**Gyltene Retkoceri**, u përgjigj se nuk ka, dhe se vetëm kjo kryesorja me sa din ka.

**Armend Ademi**, ngriti dy çështje: problemin kryesor që është tek punësimi i PAK-ra, dhe ligji që e mundëson 50 plus 1 me aftësi të kufizuar. Ai theksoj që përgjegjës për monitorimin e tyre është Inspektorati i Punës i Komunës që duhet të angazhohet dhe t'i inspektojë të gjitha kompanitë që operojnë, se secila kompani sa i përfillet ligjit, sa e përfillë ligjin, secila kompani sa ka punëtorë, sa i ka përqindjen me AK.

Çështja e dytë ishte parkingu i qytetit, ku ai pyeti se kur kanë dërguar e-mail për punën e parkingut.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se ka një javë apo 10 ditë që janë duke punuar në rregullore.

**Armend Ademi**, tha se puna e parkingut është një problem që është një vit që ekziston, dhe se nuk është fjala vetëm si komunitet i shurdhër por për të gjithë PAK, të cilët po kanë problem me qasjen në parking.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se është e vërtetë se janë bërë një vit që komiteti ka paraqitur kërkesë tek "Prishtina Parking" për ti liruar PAK, dhe se përgjigjën e fundit që e kanë prej z. Ilirik Musliu është ajo që ende nuk e kanë përfunduar rregulloren e "Prishtina Parking" dhe që premtimet janë që gjithsesi se kjo kategori do të lirohet nga pagesa.

**Fatime Demolli**, kryesuese po ashtu theksoj që ende janë në pritje të një përgjigje sepse ende nuk ka përfunduar rregullorja, dhe ajo u sugjeroj secilit anëtarë që ta përcjellë këtë rregullore kur del në diskutim publik, dhe në grupin e përbashkët të komitetit ku kanë qasje, cili e sheh i pari të ndërhyjë.

**Ramadan Salihu**, tha se i ka thënë z. Habib Qorrit kur ka qenë në takim me Kryetarin Përparim Rama, se në qoftë se kemi dispozitë ligjore dhe e kemi PV i cili flet çartë, PV nuk ka nevojë që të pritet një akt nënligjor i cili mund të del në diskutim por i cili mund edhe të zvarritet. Ai ceku se PAK-ra, kanë telashe të mëdha, sepse "Prishtina Parking", e kërkon tarifën e parkingut të automjetit para banesës dhe kjo për PAK-ra, është shumë problem i madh dhe se duhet që me një vendim deri në zgjedhjen e rregullores, siç e ka bërë "Trafiku Urban", p.sh. për lirimin e PAK-ra, me biletë nuk e ka pritë rregulloren, por ka bërë vendim të cilin e ka shpërndarë nëpër autobusë dhe kështu PAK nuk kanëasnë problem qarkullimi. Ai u pajtua 100% me kolegut Armend, që kjo punë kërkon zgjidhje të menjëhershme sepse ka mundësi juridike.

**Mehreme Llumnica**, tha se në planin e mobilitetit që e kanë pas të BERZH-it, kanë marrë pjesë "Hendikosi", janë ftuar është e rregulluar edhe me udhëzim administrativ janë qasja në pjerrina, janë ato me masa, me parametra, është udhëzimi administrativ për qasjen të objekteve, të pjerrinave të gjitha janë me standarde aty, çdo gjë është e rregulluar, por tjetër është që nuk zbatohen, dhe se ata e kanë dokumentacionin.

**Roland Peraj**, këshilltar pyeti nëse e kanë planin e mobilitetit, me ja dërguar një draft final të tij. Po ashtu ju përgjigj Armendit se sa i përket çështjes së parkingut duke thënë se është e re për të si informatë dhe se nuk e ka pas idenë se çfarë ka ndodhur. Ai kérkojë ti dërgohen korresponcat e e-maileve që kanë pasur me drejtortë dhe kërkesat që janë dërguar dhe ai ta sheh deri ku ka shkuar çështja dhe ku ka ngecur.

Ai theksoj se do të interesohet personalisht edhe me Ilirikun drejtorin apo edhe me kryeshefin e "Prishtina Parking" z. Sokol Havolli, për ta parë mundësinë me gjet zgjidhjen më të mirë në mënyrë që me iu liruar.

**Mehreme Llumnica**, tha se përveç lirimt nga autobusët publik, që është një veprim shumë i mirëseardhur nga "Trafikut Urban", e të cilët e kanë lehtesar shumë punën, ata kanë edhe një kërkesë se çfarë do të bëhet me transportin me taksi.

Ajo tha se e kanë cekur edhe me Ilirikun edhe në PV-të, kompanitë private të takstive i kanë mbi 40 taksi dhe kur t'i regjistrojnë kompanitë nuk e kanë asnjë veturë me qasje për përdoruesit e karrocave dhe ato vutura nuk i përdorin vetëm PAK, por edhe të mos huarit. Për shembull çdo kompani që i ka mbi 10 vutura nëse kërkon leje për regjistrim nga komuna me pasur kriter që së paku një veturë apo dy me mekanizmin për aftësinë e kufizuar.

**Armend Ademi**, kérkoj ti dërgohet në e-mail puna e "Prishtina Parking".

**Fatime Demolli**, kryesuese u pajtua t'ia përcjellë sepse ka e-mail që ajo ka dërguar nga e-maili i saj personal, dhe propozoj të hapet një e-mail i komitetit, kështu që cilat do e-maila që ajo i ka nga "Prishtina Parking", vetëm do tua bëj forward dhe kështu të shikohet se kur kanë bërë kërkesë, si ka shkuar rrjedha e takimeve të cilat i kanë bërë edhe me anëtarët e "Prishtina Parking".

**Armend Ademi**, ceku se në vitin 2012 apo 2013 kanë pasur telashe me transport publik, sepse ata e bënin ligjin vetëm PAK-ra, nuk i cekshin të gjitha kategoritë e AK.

**Mehreme Llumnica**, tregoj se kanë pas takim me drejtorin e "Trafikut Urban" dhe e kanë bërë për të gjitha llojet e aftësive së kufizuara.

**Armend Ademi**, u shprehë se prej asaj kohe nuk kanë më asnjë telashe me transportin publik dhe se tanë problemi është te "Prishtina Parking".

**Mehreme Llumnica**, tha se siç e ka cekë Armendi edhe tek "Prishtina Parking" edhe tek parkingjet ata me gjasë vetëm përdoruesit e karrocave po i llogaritin PAK-ra, e për këto llojet si ajo apo pak më të rëndë nuk kanë qasje në parking dhe ai e ka vështirë me e lënë veturën diku e me shkuar larg, të mos flasim edhe për pagesat ku shumica janë të pa punë.

**Ramadan Salihu**, tha se kjo nuk është punë mëshire, por është obligim ligjor.

**Roland Peraj**, këshilltar informoi se javën e kaluar është mbajt një takim i radhës me z. Halil Kastrati dhe janë duke e sjellë një investim shumë të madh në Komunën e Prishtinës që lidhet direkt me PAK ku vlera e investimit është diku rrëth 20 milion euro, është në periferi të Prishtinës. Pra ata janë duke caktuar një lokacion mbi 10 hektarë tokë, ku ka me u vendosë një qendër e madhe shumë moderne për PAK, kryesisht me dëmtime intelektuale, përfshirë Autizmin, Down Sindrome. Model ky i cili është i Dubait dhe është fjala e fundit e teknologjisë, është investim marramendës, i jashtëzakonshëm dhe për fat të mirë modeli është i Dubait do të thotë janë arab.

**Mehreme Llumnica**, pyeti se a ka me qenë qendër ditore.

**Roland Peraj**, këshilltar u përgjigj që qendra ka me qenë gjysmë ditore, rezidenciale, në të cilën ka me pas terapi të artit përmes muzikës, kulturës dhe kalërimit, do të jetë edhe për fëmijë edhe për të rritur, do të thotë do të jetë e miksuar.

**Mehreme Llumnica**, e përkrahu shumë këtë ide që është vetëm për dëmtime mendore, e cila është shumë e mirëseardhur, sepse personat që e fitojnë aftësinë e kufizuar prej sëmundjeve të ndryshme, fatkeqësive të ndryshme, kanë një nevojë për ato shërbime.

**Roland Peraj**, këshilltar shpjegoi që ky është program i specializuar, dhe sipas informatave të tij, ata që kanë dëmtime intelektuale, Down Sindrome, Autizëm dhe formave tjera që mundën me qenë, ideja është që kanë me qenë më shumë të specializuar dhe secila formë apo ekip ka me qenë vetëm për një kategori të caktuar.

**Mehreme Llumnica**, reagoi duke i thënë z. Peraj që qendra ditore është bërë, qendra për autizëm tash edhe një objekt tjeter, e kategoritë tjera ku do të mbasin sepse kanë nevojë shumë për shërbime.

**Fatime Demolli**, kryesuese pyeti z. Peraj se kur pritet të filloj kjo.

**Roland Peraj**, dha sqarime për pyetjet e parashtuara.

**Fatime Demolli**, kryesuese theksoj se sa është e rëndësishme që PAK-ra, ta kenë një qendër, një qëndrim ditor, ata e kanë në arsim por po e përfundojnë shkollën fillore, shkollimin e mesëm dhe ku tutje. Sipas saj kjo është shumë e mirëseardhur dhe beson që është në interes të AK.

**Ramadan Salihu**, paraqiti çështjen e mëditjeve duke thënë se në qoftë se Asamblesë Komunale iu ka rritur pak mëditja, të ardhurat për pjesëmarrje në mbledhje, atëherë si mund të bashkëpunohet në këtë pikë që t'i ekuivalentohet edhe komitetit e njëjtë gjë.

**Fatime Demolli**, kryesuese informoj z. Peraj që atyre mëditjet ua paguan Kuvendi Komunal, me një shumë simbolike dhe secili pas një takimi ka dhe detyra e përgjegjësi të tjera që i jepen për më i kryer ato ditëve të tjera, andaj ajo kërkoj të ju ndihmohet në këtë pjesë, të na shtyni apo bisedoni se si është mundësia e pagesës së komitetit.

**Roland Peraj**, këshilltar pyeti për personat që nuk marrin pjesë në takim a paguhen dhe a kanë ndonjë rregullore se si e rregullon mundësinë që këta që nuk vijnë do me thënë si mundet të zëvendësohet, a ka rregullore.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se nuk paguhen, pra nuk ka rregullore.

Ajo ka kërkuar me email që duhet të jetë një rregullore madje rekandomdimin që e kanë bërë me z. Salihu ka dal në një përfundim që duhet të jetë një rregullore e komitetit, në këtë rast për PAK-ra, mandatimi i tyre, përgjegjësia dhe zëvendësimi i anëtarëve kur mungojnë me muaj të tërë në mbledhje të komitetit.

**Roland Peraj**, këshilltar tha se nuk e njehë këtë spektrin ligjor se si mund të bëhet kjo por ajo çfarë ai mund të bëjë është ta shfaq vullnetin dhe interesimin për ta bërë këtë, pasi që ai ka bindjen që me të vërtetë meritojnë më shumë se 100 euro, por duhet ta shohim këtë mundësi se si mund të bëhet.

Ai pati edhe një kërkesë nga ana e tyre, që si anëtarë të komitetit me e pas një draft propozim se si dëshirojnë me e pa rregulloren, kështu që z. Peraj shprehu dëshirën me e lënë një deadline dhe kur ti dërgohet, ai tu jap imputet e tij dhe të shikohet se si mund të pasurohet ajo akoma më shumë. Ai bashkë me Premtimen tha se do ta dërgojnë në Zyrën Ligjore dhe pastaj do ta shohin si me e rregulluar për të mos pasur ngecje. Ai iu premtoj që çfarë do që është në vullnetin e tyre do të bëj maksimumin për ta shtyrë idenë përpara që të paktën me 30 mars me u dal me rritje ose nëse nuk munden të paktën prillin, gjithmonë nëse ekziston mundësia ligjore.

**Fatime Demolli**, kryesuese shprehu gatishmërinë për tu angazhuar edhe si komitet edhe si anëtarë të komitetit, për ta bërë një lloj rregullore se çfarë përbajnë, përgjegjësitë e një anëtarë të komitetit, përgjegjësitë e një kryesuese të komitetit, sepse nuk janë përgjegjësitë e ndara dhe realisht kryesueses i bie me pas pak më shumë përgjegjësi në mbledhje dhe takime.

**Roland Peraj**, propozoi që kjo rregullore përveç anëtarëve me mandat të rregullt me qenë edhe disa kolegë asamblistë që vijnë këtu e jepin imputet e tyre, me obliguar që kabinetin i kryetarit me qenë i obliguar me deleguar kryetari në emër të tij dikë, siç është ai në këtë rast edhe pse është pa ndonjë delegencë, pra ideja është që me e pas obligim sepse Përparimi ka vetë vullnet, ligjërisht me këtë rregullore me e obliguar.

**Mehreme Llumnica**, dha shembull me e pas një këshilltarë për aftësinë e kufizuar.

**Fatime Demolli**, kryesuese tha se në vendim u është thënë që çdo sugjerim i komitetit, kryetari do ta marrë për bazë atë, e që realisht ata kanë kaluar dy mandate e nuk janë takuar kurrë me kryetarin, e në vendim thuhet që të dalat nga komiteti do të janë urë lidhëse me kryetarin dhe ai do t'i zbatojë sugjerimet e komitetit kështu që atyre u ka munguar kjo urë lidhësja e komitetit, qoftë me ata personalisht, qoftë me dikë të kabinetit, sepse ato rekandomdime që i kanë dhënë janë në ueb-faqe por jo tek njerëzit kompetent dhe nëse i kanë dërguar tek njerëzit kompetent nuk është që është ndërmarrë ndonjëherë diçka, ndonjë iniciativë, pra është dashur me e-mail apo telefonata për ti ftuar në një takim, kështu që po shpresoj që nëse kjo rregullore bëhet me e specifikuar edhe detyrat e kryesueses, të anëtarëve apo se si të ndahen anëtarët varësisht prej

- aftësi së kufizuar, pra jam e bindur që në këtë rregullore do të futet edhe ajo mëditja krahas përgjegjësive të anëtarëve. Kështu znj. Demolli tha që do të punojnë në këtë, do t'ua dërgojnë brenda javës, duke e pas parasysh kontributin e anëtarëve e mbi të gjitha z. Ramadan i cili në shkrime nuk heziton dhe ka edhe të tjerë që dërgojnë komente.

**Mehreme Llumnica**, tha se më specifik dhe më kompetent për rregullore se z. Salihu nuk është asnjëri. Tek dallimi i anëtarëve se sa jep kontribut dhe përgjegjësit tek pagesat nuk mundet me pas dallim sepse nuk kanë as anëtarët e asamblesë, e kanë shumën e njëjtë, ndërsa tek kryesuesi mundet me pas pak dallime sepse ka më shumë përgjegjësi.

**Ramadan Salihu**, kërkojë që pasi ju ka rritë asamblistëve, mëditja të ju rritet edhe atyre, pra 10% atyre, 10% neve, sepse për ndryshe motivacioni bie dhe në të ardhmen duhet kriteret t'i ndryshohen. Ai tha se për rregullore në të cilën ai beson, do të kontribuojnë në atë drejtim, mirëpo me të vjetrën duhet që anëtarë në bazë të konkursit të jetë të paktën me fakultet do të rrezikohet situata kur ai kriter nuk mund të plotësohet sepse nuk ka.

**Mehreme Llumnica**, tha se nuk d.m.th që nuk ka fakultet kur e ka një eksperiencë të madhe të punës.

**Jeton Canhasi**, tha se përshëndet këtë ide për tu bërë një qendër të madhe shumë moderne për PAK-ra, kryesisht me dëmtime intelektuale, që është model i Dubait. Ai shtroi një pyetje se a do të jetë ajo e shtetit apo prapa saj sillet dikush dhe në fund i merr ato 10 hektarë dhe atë e shndërron në privatizim, pra nëse e merr Komuna si Komunë e mandej bëhet punësimi, por nëse shkon në privatizim ajo do të dështojë.

**Roland Peraj**, këshilltar u përgjigj se jo, ajo është OJQ, nuk është private, aty vendosen kriteret e në bazë të atyre kritereve nuk i lejon as ata për të gabuar por në të njëjtën kohë as neve, tash na mbron ligji të dy palët, edhe subjektin që investon edhe në këtë rast Komunën.

Po ashtu tha kisha propozuar përtej punës ndoshta një ditë me e lënë vetëm një takim për kafe me Kryetarin, pa diskutuar aspak për punë vetëm për qejf, kështu që po e marr përsipër me e gjet një hapësirë kohore të Kryetarit të paktën me pi kafe me Kryetarin.

*Mbledhja përfundoi në ora 15:25.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit  
Fatime Demolli-Mustafa

